



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE- NATIONAL AUDIT OFFICE

Prishtinë, 05 janar 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit, shpallë interesin për:

MARRJE ME QIRA TË NJË OBJEKTI

Zyra Kombëtare e Auditimit, është në kërkim të një objekti me qira për vendosjen e punonjësve të saj për ushtrimin e veprimtarisë së përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Për këtë qëllim, kërkohet një objekt të destinuar për veprimtari administrative dhe i përgatitur me infrastrukturën përcjellëse.

Ofertat e tyre mund t'i paraqesin subjektet e interesuara, objektet e të cilëve i plotësojnë kushtet administrative dhe teknike të paraqitura në këtë shpallje.

Kushtet e detyrueshme administrative që duhet të plotësoj objekti:

1. Të mos ketë çështje të pa rregulluara pronësore, çështje në kontest apo që objekti të jetë i vendosur nën hipotekë;
2. Pronari i objektit të ketë lejen e ndërtimit;

Kushtet e detyrueshme teknike që duhet të plotësoj objekti:

1. Të jetë në zonën urbane të Qytetit të Prishtinës (në një perimetër jo më larg se 2.5 km nga qendra e qytetit, përkatësisht nga Hoteli Grand);
2. Madhësia e përgjithshme e objektit (bruto) të jetë prej 2900m² deri në 3100m² dhe të jetë i ndarë në zyrë pune. Të prezantohet dëshmia për madhësinë e objektit;
3. Të ketë hapësira/salla ku do të mbahen takimet zyrtare dhe trajnimet e punonjësve;
4. Të ketë së paku nga dy nyje sanitare të veçanta në secilën etazh (kat) të objektit;
5. Të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyral brenda objektit;
6. Të ketë qasje në ngrohoren e qytetit ose të ketë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore me derivate të naftës;

7. Të ketë instalime të ligjshme në sistemin elektrik, sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit të qytetit.
8. Të ketë të instaluar sistemin për ventilim - Air Kondicionerë;
9. Të ketë hapësirë për parkimin e së paku shtatë (7) automjeteve zyrtare.

Kërkesat e preferuara teknike që duhet të plotësoj objekti:

1. Të ketë më shumë se një hyrje në objekt dhe hyrja e automjeteve në oborr (vend-parkim) të jetë e veçantë për automjete;
2. Oborri të jetë i rrethuar me rrethojë;
Të ketë ndriçim të duhur përgjatë gjithë perimetrit të jashtëm të objektit;
3. Të ketë të instaluar LAN në gjithë hapësirat e objektit;
4. Të ketë të instaluar dhe funksionale shkallët për dalje emergjente;
5. Të ketë rezervuar uji për emergjencë nga 3000 l deri në 4000 l, alternativ rrymor;
6. Të ketë gjeneratorin për shërbime esenciale me rezervuar për furnizim me karburante;
7. Të ketë të instaluar sistemin e alarmit kundër vjedhjes.

Informatat tjera:

Zyra Kombëtare e Auditimit, planifikon lidhjen e kontratës për qiranë e objektit për një periudhë të caktuar deri në tri vite. Në rast se nuk krijohen mundësit për vendosje të ZKA-së në ndonjë nga objektet Qeveritare, atëherë ekziston mundësia e vazhdimit të kontratës sipas marrëveshjes së ri-negociuar ndërmjet palëve.

Gjatë muajit gusht 2018, planifikohet përgatitja e objektit dhe bartja e inventarit, kurse vendosja e punonjësve dhe fillimi i punës do të bëhet prej datës 1 shtator 2018.

Paraqitja e ofertave:

Personat e interesuar duhet të paraqesin këto dokumente:

1. Dokumentin identifikues të pronarit;
2. Certifikatën e pronës (jo më të vjetër se 30 ditë);
3. Kopjen e lejes së ndërtimit;
4. Skicë të përgjithshme të objektit;
5. Çmimin i ofruar për metër katrorë si dhe çmimi total për qiranë mujore të objektit.

Subjektet e kontaktuar për negociim të kushteve të kontratës duhet të prezantojnë kopjen e projektit teknik të objektit, në formë të shtypur apo elektronike.

Subjekti i përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës, paraprakisht duhet të paraqesë:

1. Dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore lidhur me atë objekt;
2. Dëshmitë për kryerjen e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike deri në ditën e planifikuar për lidhjen e kontratës.

Ofertat e kompletuara, me kuvertë të mbyllur dorëzohen në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, në adresën rr. Musine Kokalari” nr. 87 – Prishtinë.

Ofertat mund të dorëzohen brenda 15 ditëve, prej ditës së shpalljes, përkatësisht deri me datën 22 janar 2018.

Zyra Kombëtare e Auditimit mban të drejtën e vizitës paraprake në objekte dhe për negocimin e kushteve specifike.